

DEKLARATË

për informim profesional dhe me etikë për temat në lidhje me LGBTI

Inicues: Koalicioni MARGINI, Këshilli për etikë në medime, Shoqata e gazetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale

Të brengosur për gjuhën e pranishme diskriminuese, dërrgoguese dhe stigmatizuese ndaj njerëzve të LGBTI, dhuna ndaj njerëzve të LGBTI dhe aktivistëve për të drejtat e njeriut, si dhe shkalla brengosëse e paragjyqimeve dhe mostolerancës ndaj kësaj bashkësie të marginalizuar në shoqërinë e Maqedonisë.

Duke shqyrtuar faktin se raportet ndërkombëtare dhe hulumtimet nacionale potencojnë se prania e gjuhës së urrejtjes në disa medime kontribuon për nxitjen e dhunës dhe prodhimin e diskriminimit ndaj kësaj grupe dhe se shpesh herë medimet nuk e njohin diskriminimin dhe përjashtimin social të njerëzve të LGBTI,

Të vetëdijshëm për rolin e jashtëzakonshëm të medimeve në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me qëllim të afirmimit të pluralizmit shoqëror, barazisë dhe dallimeve,

Duke përkujtuar se standardet profesionale të gazetarisë obligojnë për respektimin e dinjitetit njerëzor, dënimin e gjuhës së urrejtjes dhe të diskriminimit në bazë të orientimit social, identitetit gjinor, statusit shëndetësor, social si dhe karakteristikave tjera,

Duke theksuar rëndësinë nga njohja dhe dënimi i diskriminimit, gjuhës së urrejtjes, dhe të dhunës ndaj grupeve të marginalizuara, si mënyrë me të cilën medimet mund të ndihmojnë për tejkalimin e pabarazisë dhe shkeljeve të të drejtave themelore njerëzore të LGBTI,

E nënshkruam këtë Deklaratë për informim profesional dhe me etikë për temat në lidhje me bashkësinë LGBTI dhe pa hamendje shprehim përpjekjet dhe mundimet tona për të kundërshtuar dhe parandaluar gjuhën diskriminuese dhe derroguese ndaj kësaj grupe, nëpër medime dhe të promovojmë dallimet sekusale dhe gjinore, si dhe mbrojtjen e të drejtave të LGBTI, përmes këtyre parimeve:

1. **Informim pa stereotipe për LGBTI;**
2. **Përmbajtje dhe dënim të gjuhës së urrejtjes** në bazë të orientimit seksual, identitetit gjinose ose cilës do përkatësi të një grupe të marginalizuar historike ose shoqërore;
3. **Informim për viktimat e dhunës dhe diksriminimit** të ngjyrosur me empati dhe solidaritet;
4. **Informim të pandarë për aktivitetet e bashkësisë LGBTI dhe aktivistët për të drejtat e njeriut** në kuadër të sferës shoqërore, politike dhe kulturore, duke respektuar edhe integritetin e tyre personal, mendimin si dhe aktivitetet;
5. **Inkluzion të zërave dhe perspektivave të njerëzve të LGBTI dhe aktivistëve për të drejtat e tyre**, në materialet me tema që i tangojnë ato drejtpërdrejt, si dhe ngjarje dhe probleme që e tangojnë tërë shoqërinë e Maqedonisë;
6. **Respektimin dhe implementimin e vendimeve dhe rekomandimeve të trupave dhe shoqatave të esnafëve, vetërregullatorëve dhe rregullatorëve** në lidhje me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave njerëzore të LGBTI;
7. **Sensibilizimin e punëtorëve mediatik** për informim në lidhje me tema të LGBTI;
8. **Bashkëpunimi me shoqatat civile që i përfaqësojnë të drejtat e LGBTI**, përmes shkëmbimit të informatave që do të mundësojnë një prezantim integral dhe të pandarë të problemeve që i tangojnë LGBTI;

Ne, nënshkruesit e kësaj Deklarate, obligohemi që në kuadër të përgjegjësisë dhe kompetencave personale të qëndrojmë të përkushtuar ndaj parimeve të lartpërmendur dhe ti thërrasim të gjitha palët që të kyçen dhe të kontribuojnë për ndërtimin e shoqërisë në të cilën të gjithë kanë qasje të barabartë në drejtësi.

Inicues të Deklaratës:



Nënshkrues të Deklaratës:

Shoqata e medimeve të shtypura

Shoqata e medimeve private elektronike

PORTRET Magazin

Televizija 24

Video portal –NOVA TV

SHTR TV Moris - Ohër

Redaksia digjitale Sakam da kazham

MKD.mk

Televizioni MTM – Prva skopska

Sloboden pečat

Portal Plusinfo.mk

SHTR Capitol FM

SHTR Televizioni Koçani LD

Globus Magazin

Portal Telegrafi.com

SHTR SITI Radio

Radio Goldi - Veles

SHTR Lajf Radio

SHTR Modea Radio - Shën Nikollë

SHTR KLUB FM